

REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
INSTITUTI PEDAGOGJIK I KOSOVES
PEDAGOSKI INSTITUT KOSOVA

Nr / Br. 23/25 Nr. faq / Br.str 05
Data / Datum. 19.02.2025
PRISHTINE / PRISTINA



RREGULLORE

**PUNE E KËSHILLIT SHKENCOR TË INSTITUTIT
PEDAGOGJIK TË KOSOVËS**

Prishtinë, 2025

Duke u bazuar në nenin 24, të Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtarin Kërkimore-Shkencore, nenit 16 të Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr.8/2017 për Institutin Pedagogjik të Kosovës, si dhe në bazë të neneve 35 dhe 36 të Statutit të Institutit Pedagogjik të Kosovës, të datës: 11.06.2024, Këshilli Shkencor, në mbledhjen e mbajtur më datë 19.02.2025, miratoi këtë:

**RREGULLORE
PUNE TË KËSHILLIT SHKENCOR TË INSTITUTIT
PEDAGOGJIK TË KOSOVËS**

I. DISPOZITAT E PËRGJITSHME

**Neni 1
Qëllimi**

Me këtë Rregullore përcaktohen: mënyra e punës, përbërja, detyrat, thirrja dhe mbajtja e mbledhjeve, mënyra e marrjes së vendimeve dhe zbatimi i tyre, si dhe çështjet e tjera të punës së Këshillit Shkencor (KSH) të Institutit Pedagogjik të Kosovës (IPK).

Neni 2

Përbërja e Këshillit Shkencor

1. Këshilli Shkencor përbëhet nga:
 - 1.1. Drejtori;
 - 1.2. Sekretari shkencor ex-officio;
 - 1.3. Shefat e Departamenteve, shkencor dhe profesional;
 - 1.4. Dy anëtarë (2) të jashtëm, me titull shkencor, të cilët emërohen me vendim të drejtorit të IPK-së, pas miratimit të Këshillit Drejtues.
 - 1.5. Sekretari i IPK-së, pa të drejtë vote, i cili, po ashtu, e mban edhe procesverbalin.
2. Mandati i anëtarëve të Këshillit Shkencor është 4 vjet, me mundësi të rizgjedhjes edhe për një mandat.

Neni 3

Detyrat e Këshillit Shkencor

1. KSH është organ profesional i IPK-së i cili:
 - 1.1. Shqyrton dhe vendos çështjet shkencore dhe profesionale;
 - 1.2. Propozon kandidatët për drejtor të Institutit, nga lista e kandidatëve të paraqitur në konkurs;
 - 1.3. Cakton komisionet, zhvillon dhe mbikëqyrë procedurën e zgjedhjes në tituj shkencorë dhe në tituj hulumtues;
 - 1.4. Shqyrton dhe propozon planin e punës kërkimore-shkencore dhe të veprimtarisë botuese të Institutit;
 - 1.5. Shqyrton raportin e punës kërkimore-shkencore të Institutit.

2. Në bazë të propozimeve të sektorëve, zgjedh kryeredaktorët dhe anëtarët e redaksive të revistës dhe të botimeve të veçanta të Institutit.
3. Vendos edhe për çështje të tjera, të cilat për nga rëndësia e tyre profesionale dhe shkencore duhet t'i shqyrtojë KSH.
4. KSH përkrah aftësimin e kuadrove shkencorë dhe profesionalë të IPK-së.

Neni 4 Thirrja dhe mbajtja e mbledhjes

1. Mbledhjet e KSH-së i thërret dhe i kryeson drejtori i IPK-së.
2. Drejtori përcakton kohën dhe vendin e mbajtjes së mbledhjes dhe përgatit rendin e ditës të mbledhjes. Anëtarët e KSH-së njoftohen, në kohë të përshtatshme, por së paku 48 orë përpara mbledhjes, për mbajtjen e mbledhjes së radhës dhe rendin e ditës.
3. KSH në mbledhje dhe komisione punon si organ kolegjal, për të pasur kuorum duhet të marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve.
4. Drejtori detyrohet të thërrasë një mbledhje, nëse kërkohet me shkrim nga të paktën një e treta (1/3) e anëtarëve. Kërkesa e një të tretës (1/3) të anëtarëve duhet të përcaktojë çështjet që kërkohen të diskutohet.
5. Në mungesë të drejtorit, ose në rastet kur drejtori mund të jetë në konflikt interesi, mbledhjen e KSH-së e thërret dhe udhëheq sekretari shkencor.
6. Mbledhja e KSH-së mbahet me prezencën fizike të anëtarëve. Me pëlqimin e shumicës së anëtarëve, mbledhja mund të mbahet edhe me pjesëmarrjen e anëtarëve nëpërmjet video-konferencës apo me mjete të tjera të përshtatshme të komunikimit simultan në distancë.

Neni 5 Mënyra e vendimmarrjes

1. Vendimet e KSH-së merren me votim të hapur, i cili realizohet me zë, me shenja apo çdo formë tjetër të përshtatshme.
2. Vendimet që lidhen me zgjedhjen e një individi merren me votim të fshehtë.
3. Vendimet e KSH-së merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje.
4. Në rast të votave të barabarta, vota e kryesuesit është përcaktuese, përveç kur ai ka një pengesë ligjore për të votuar sipas ligjit.

Neni 6
Zbatimi i vendimeve

Për zbatimin e vendimeve të KSH-së përgjegjës do të jetë drejtori i IPK-së.

Neni 7
Mbajtja e procesverbalit

1. Në çdo mbledhje mbahet procesverbal, për të cilin përkujdeset Sekretari i IPK-së apo zyrtari i emëruar nga drejtori.
2. Procesverbali nënshkruhet nga kryesuesi, anëtarët e KSH-së dhe procesmbajtësi
3. Procesverbali duhet të përmbajë këto elemente:
 - 3.1. Vendin, datën dhe kohën e fillimit dhe të mbarimit të mbledhjes
 - 3.2. Rendin e ditës
 - 3.3. Listën e pjesëmarrësve
 - 3.4. Të gjitha propozimet dhe rezultatet e votimeve përkatëse
 - 3.5. Shënimet thelbësore mbi rrjedhën e mbledhjes
 - 3.6. Dokumentet shtesë, sipas nevojës, i bashkëngjiten procesverbalit si aneks
4. Procesverbali duhet të përgatitet brenda një jave pas mbledhjes së KSH-së dhe si ekstrakt duhet t'ju dërgohet të gjithë anëtarëve të KSH për plotësim dhe ndryshim eventual.
5. Procesverbali miratohet në fillim të mbledhjes së radhës së KSH-së.
6. Procesverbali ruhet në arkiv të IPK-së me materialet shqyrtuese, sipas pikave të rendit të ditës, si dokument afatgjatë.

Neni 8
Zbatimi i rregullores

Këtë rregullore e zbaton KSH i IPK-së, drejtori dhe personat e tjerë të ftuar apo të angazhuar në funksionimin dhe punën e KSH-së.

Neni 9
Mbikëqyrja e zbatimit dhe interpretimi i Rregullores

1. Për zbatimin e kësaj rregullore kujdeset kryesuesi i KSH-së.
2. Interpretimin autentik të kësaj rregullore e bëjnë KSH dhe zyrtari ligjor në IPK.

Neni 10
Ndryshimet dhe plotësimet

Çdo ndryshim apo plotësim në këtë rregullore duhet të bëhet në bazë të procedurës së njëjtë të nxjerrjes dhe të miratimit të saj.

Neni 11
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga KSH dhe nënshkrimit të saj.

Prishtinë, 19.02.2025

Kryesuesi i KSH-së

Dr.sc. Osman Buleshkaj

